

**AKT THEMELIMI  
STATUTI I SHOQERISE  
“NIHAL INTERNATIONAL”**

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 " Për Qëndrën Kombëtare të regjistrimit", u vendos si më poshtë:

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1  
DATA E THEMELIMIT DHE EMRI I SHOQËRISË**

Sot me datë **11.01.2023** ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**NIHAL INTERNATIONAL**" sh.p.k (në vijim referuar si "Shoqëria").

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Z. Taran SINGH**, Lindur në **PANDER,PUNJAB-INDI** me **19.08.1994**, Shtetas **INDIAN** me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pashaportes me numër **V3322291**,

**NENI 2  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

**Objekti i Shoqërisë do të përfshijë:**

- 1- Sherbime konsulence,komisionere,agjensi tregetare,ndermjetimi ose perfaqesimi i firmave te huaja apo vendase.
- 2-Kerkime ne internet gjetje klient potenciale ne fushen e hoteleri-turizmit,ndertimit,industries mekanike,industries se lehte etj.
- 3-Cdo transaksion tregetar (shitje-blerje dhe dhenie me qera) ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme ,shite-blerje mjetesh te cdo tipi dhe madhesie etj.
- 4-Import-Eksport automjetesh te perdonura dhe shit-blerjet e tyre, dhenie automjetesh me qira.
- 5-Kryerja e çdo lloj aktiviteti të lejueshëm nga ligji për formën juridike të subjektit.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

*Taran Singh*

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pa caktuar.

**NENI 4  
SELIA**

- (I) Lagija nr.12, Rruga N. Libohova. objekt me nr.pasurie 4/38+1-1, zona kadastrale 8513-Durres .
- (II) Adresa e shoqërisë për komunikime elektronike është si vijon:  
**nihalinternational22@gmail.com.**

**NENI 5  
TË NDRYSHME**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtoje ortakë, të zmadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit 9901 date 14.04.2008, “Tregëtarët dhe Shoqërítë Tregëtarë”.

**KREU II  
KAPITALI**

**NENI 6  
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë **eshte 100.000 leke.**

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Taran SINGH**: Zoterues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **100.000 lekë** që përben **100 % të kapitalit themeltar** të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**NENI 7  
ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **NENI 8** **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton atë per gjigjet ne mënyrë solidare ndaj Shoqërise për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i koutës nga çasti i kalimit të koutave deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

## **KREU III** **ORGANI VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

### **NENI 9** **ORGANI VENDIMARRËS**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme, perjashtohet rasti kur Administratori është dhe ortak i vetëm.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin

edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

## **NENI 10 MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 11 KOURUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## **NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vodos me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **NENI 13**

Tarrah Singh

## PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## NENI 14 ADMINISTRIMI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Afat i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje nëpërmjet vendimit të asamblese së ortakeve të Shoqërisë.

Në asnjë rast ortakeve nuk ju duhet të justifikojnë apo të provojnë se cilat janë shkaqet për te cilat shkarkohet Administratori.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1-Administratori i Shoqërisë është **Z. Taran SINGH**, Lindur në **PANDER, PUNJAB-INDI** me **19.08.1994**, Shtetas **INDIAN** me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pashaportes me numër **V3322291**, nga **data 11.01.2023 deri me date 11.01.2028**, me të drejtë ripërtëritjeje nëpërmjet vendimit të asamblese së ortakeve të Shoqërisë.

## NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thëraxe Asamblene e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që

- aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **NENI 16 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëmë shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

1. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**NENI 17  
MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**KREU IV  
VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

**NENI 18  
VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**NENI 19  
EKSPERTET**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithevetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzoje në kohë ortakeve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore qe ka.

**KREU V  
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**NENI 20  
PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 te Nenit 43 te ligjit Nr.9273 date 03.05.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

e) Me vendim te Gjykatës

f) Për arsyet tjetra të parashikuara në statut.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë

“Shoqëria në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërise tregtarë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **NENI 21 RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë.”

### **NENI 22 BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë", Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 23 MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarreveshjet që mund te lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### ***ORTAKETE SHOQERISE***

### ***I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

**“NIHAL INTERNATIONAL” sh.p.k.**

**Z. Taran SINGH**

*Taran Singh*

*Asistoka në  
per kthim.*

*Anoli Seidaj*